

1 E martë, 1 prill 2025

2 [Seancë e hapur]

3 [Të akuzuarit hyjnë në sallën e gjyqit]

4 [I akuzuari Krasniqi paraqitet përmes

5 videolidhjes]

6 --- Seanca fillon në orën 09.02

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Sekretare e
8 seancës, ju lutem paraqisni lëndën.

9 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Mirëmëngjes, të nderuar
10 Gjykatës, kjo është lënda KSC-BC-2020-06, Prokurori i
11 Specializuar kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep
12 Selimit dhe Jakup Krasniqit.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Vërej që me
14 përjashtim të z. Krasniqi që na ndjek përmes videolidhjes, të
15 akuzuarit e tjerë janë të pranishëm në sallën e gjyqit.

16 Sot si rregull duhet të kishim filluar të dëgjonim
17 dëshminë e dëshmitarit të Prokurorisë W04747. Sidoqoftë,
18 dëshmitari nuk është në gjendje të vijë sot edhe ZPS-ja do
19 kërkojë të pranohet dëshmia e tij sipas rregullës 155.

20 Z. Prokuror, ka nevojë të kalojmë në seancë private për
21 parashtrimet tuaja?

22 Z. HALLING: [Përkthim] Po.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kalojmë në
24 seancë private.

25 [Seancë private]

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2 [Seancë e hapur]

3 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Atëherë po
5 shfrytëzoj këtë mundësi të nxjerr disa urdhra me gojë.

6 Pikësëpari, Trupi Gjykses do të vendosë lidhur me
7 kërkesën e Mbrojtjes së Veselit për mjet juridik që është
8 parashtrimi i protokolluar F02968.

9 Më 27 shkurt 2025, ekipi i Mbrojtjes së Veselit kërkoi që
10 Trupi Gjykses të urdhëronte ZPS-në të nxirrte të gjitha
11 shënimet e asokohe që janë marrë -- shënimet që janë marrë, më
12 falni, gjatë seancës përgatitore të Dëshmitarit 04745. Sipas
13 Mbrojtjes së Veselit, Dëshmitari 04745 pretendon gjatë
14 dëshmisë së tij përpara Trupit Gjykses se ZPS-ja i kishte
15 treguar atij një dokument gjatë seancës përgatitore dhe bazuar
16 në përshkrimin e dokumentit që jep Dëshmitari 04745 ky
17 dokument mund të ketë qenë një produkt i punës së brendshme të
18 Prokurorisë.

19 Mbrojtja e Veselit argumenton se u habit kur mësoi se
20 seancat përgatitore nuk incizohen. Edhe në këtë rast është e
21 nevojshme të nxirret shënimi që është marrë ditën që është
22 bërë seanca përgatitore me këtë dëshmitar. Ekipi i Mbrojtjes
23 së Veselit argumenton se shënimet janë të nevojshme që Trupi
24 Gjykses të vlerësojë besueshmërinë e dëshmitarit dhe të
25 kuptojë arsyet pse Dëshmitari 04745 refuzoi t'u përgjigjej

1 pyetjeve të ZPS-së gjatë pyetjeve nga pala thirrëse.

2 Më 4 mars 2025, ZPS-ja iu përgjigj kërkesës së Mbrojtjes
3 së Veselit edhe vendosi që të rrëzohej. Sipas ZPS-së është e
4 qartë që dokumentin që përsërit në mënyrë të vazhdueshme
5 Dëshmitari 04745 në dëshminë e tij është një deklaratë e
6 mëparshme e dëshmitarit e vitit 2001, të cilën Mbrojtja e ka
7 në posedimin e vet, dhe se Mbrojtja e Veselit nuk ka paraqitur
8 arsye të vlefshme pse janë të rëndësishme shënimet shtesë.

9 Trupi Gjykses vëren se Mbrojtja e Veselit mbështet në një
10 pjesë të caktuar të dëshmisë së Dëshmitarit 04745 për të
11 mbështetur pretendimin e vet se dokumenti në fjalë që përmend
12 Dëshmitari 04745 mund të jetë një punë e brendshme, është një
13 produkt i brendshëm i ZPS-së.

14 Pasi rishikoi incizimin në tërësinë e vet, Trupi Gjykses
15 vendos se nuk ka asnjë arsye për të pranuar kërkesën e
16 Mbrojtjes së Veselit. Është e qartë nga dëshmia e Dëshmitarit
17 04745, shënimi përgatitor i ZPS-së dhe intervista e
18 Dëshmitarit 04745 e vitit 2019 me ZPS-së se dokumenti në
19 fjalë, në fakt, është deklarata e dëshmitarit e vitit 2001, të
20 cilën Mbrojtja e ka dhe nuk është një produkt i brendshëm i
21 ZPS-së.

22 Trupi Gjykses -- se Dëshmitari 04745 nuk iu përgjigj
23 pyetjeve të ZPS-së gjatë pyetjeve që i bëri pala thirrëse, por
24 këto lidheshin me deklaratën e vitit 2001. Reagimi i
25 Dëshmitarit 04745 në sallën e gjyqit kur i treguan deklaratën

1 e 2001-shit ishte në konsistencë, ishte në përputhje me
2 reagimet e mëparshme që ka pasur i njëjti dëshmitar kur i kanë
3 treguar deklaratën e 2001-shit.

4 Prandaj Trupi Gjykses nuk bindet që dokumenti që përmend
5 Dëshmitari 04745 të ketë qenë një shënim apo një produkt i
6 brendshëm i ZPS-së siç pretendon ekipi i Mbrojtjes së --

7 Sa i takon parashtimit të Mbrojtjes së Veselit se u
8 befasua të dëgjonte se seancat përgatitore nuk incizohen,
9 Trupi Gjykses rikujton se e ka shqyrtuar në hollësi dhe e ka
10 rrëzuar një kërkesë të Mbrojtjes që ZPS-ja të incizonte
11 seancat përgatitore me dëshmitarët edhe kjo është marrë në
12 vendimin mbi kërkesën e përbashkët të Mbrojtjes për ndryshimin
13 e urdhrit mbi zhvillimin e procesit gjyqësor, kjo është një
14 kërkesë që është dorëzuar më 18 qershor 2024. Krahas kësaj,
15 Trupi Gjykses vëren se parashtimet e ZPS-së se i ka dhënë
16 Mbrojtjes të gjitha dokumentet që i ka lexuar, diskutuar me
17 Dëshmitarin 04745, gjatë seancës përgatitore vlen. Nuk ka
18 asnjë informacion të mëtutjeshëm për Trupin Gjykses që të
19 bjerë në kundërshtim me këtë.

20 Rrjedhimisht, Trupi Gjykses vlerëson se kërkesa është e
21 papërligjur, e rrjedhimisht kjo kërkesë rrëzohet.

22 Trupi Gjykses udhëzon Mbrojtjen e Veselit të kërkojë
23 riklasifikimin ose të dorëzojë versionet e redaktuara publike
24 të kërkesës, kërkesa është me numër F02968, dhe
25 kundërpërgjigjes përkatësisht 02988 dhe këtë ta bëni, ju

1 lutem, deri të martën, 8 prill 2025, dhe udhëzon Zyrën
2 Administrative të riklasifkojë si publike përgjigjen e ZPS-së
3 deri më 4 prill 2025 që i bie e premtë.

4 Me kaq mbyll urdhrin e parë me gojë.

5 Urdhri i dytë është një urdhër me gojë për arsyet e
6 pranimi të dëshmisë së Dëshmitarit 04745 sipas rregullës
7 143(2)(b) dhe (c). Do t'ju japim arsyet për vendimin që kemi
8 marrë të 25 shkurtit 2025, pse u pranua deklarata e mëparshme
9 e Dëshmitarit 04745 dhe shënimi përgatitor bashkë me tri prova
10 materiale shoqëruese të dorëzuara nga ZPS-ja në përputhje me
11 rregullën 143(2)(b) dhe (c).

12 W04745 dha dëshmi në këtë proces gjyqësor më 24 dhe 25
13 shkurt 2025.

14 Më 25 shkurt 2025, gjatë pyetjeve që iu bënë këtij
15 dëshmitari ZPS-ja kërkoi që deklaratat e mëparshme të
16 Dëshmitarit 04745 të 2001-shit dhe të 2019-s, ose pjesë të
17 caktuara të tyre si dhe shënimi përgatitor bashkë me tri prova
18 materiale shoqëruese të pranoheshin sipas rregullës 143(2)(b)
19 dhe (c).

20 Mbrojtja e kundërshtoi pranimin e kësaj deklarate në bazë
21 të kësaj rregulle. Mbrojtja e Thaçit po ashtu theksoi se në
22 qoftë se Trupi Gjykses pranonte dëshminë e 04745, është të
23 bëheshin redakte përkatese.

24 Të njëjtën ditë pasi dëgjua parashtrimet e palëve, Trupi
25 Gjykses vendosi t'i pranojë dy deklaratat e mëparshme të

1 Dëshmitarit 04745 si dhe shënimin përgatitor bashkë me
2 shënimet -- bashkë me provat materiale shoqëruese në bazë të
3 rregullës 143(2)(b) dhe (c) dhe përkatësisht morën numrin
4 P02079.1, P027.9 [Sipas përkthimit] .17, po ashtu një numër që
5 iu dha ishte P02080, P02081, P02082, P02083, P02084.

6 Tani do ju japim arsyet pse e morëm këtë vendim.

7 Trupi Gjykses vëren se sipas rregullës 143(2)(b), (c)
8 ekziston mundësia që t'i bëjmë pyetje një dëshmitari i cili
9 nuk bën përpjekje të njëmendta për të dhënë dëshmi lidhur me
10 një aspekt për të cilën gjykohet se ka njohuri.

11 Sa i takon deklaratës së 2001-shit për të cilën dha
12 komente dëshmitari gjatë intervistës së 2019-s me ZPS-në si
13 dhe gjatë seancës përgatitore, (mund ta shihni, për shembull,
14 transkriptin në faqen 25502) lidhur me këtë. ZPS-ja bëri
15 përpjekje të njëmendta për t'i treguar deklaratën e vitit 2001
16 këtij dëshmitari që të shmangeshin dyshime, paqartësi edhe i
17 tregoi çdo deklaratë tjetër të mundshme apo shënime
18 Dëshmitarit 04745. Sa i përket intervistës së 2019-s, Trupi
19 Gjykses konstaton se Dëshmitari 04745 i qëndronte kësaj
20 interviste - dhe kjo është e reflektuar në transkript në faqen
21 25505 - edhe nuk kishte asnjë paqartësi në paragrafin 6 të
22 shënimit përgatitor, siç argumentonte Mbrojtja e Thaçit.
23 Sidoqoftë, ZPS-ja nuk ishte është gjendje t'i bënte pyetje
24 dëshmitarit për pjesën më të madhe të deklaratave që kishte
25 dhënë përpara ky dëshmitar - këtë mund ta shihni në transkript

1 në faqe 25506, 25516 - pavarësisht se Trupi Gjykses e
2 paralajmëroi se po shkelte urdhra të Trupit Gjykses nëse nuk
3 përgjigjej, ky dëshmitar vendosi të mos përgjigjej. Kjo është
4 faqe 25529, 25530.

5 Më tej, Dëshmitari 04745 e bëri të qartë se do t'u
6 përgjigjej vetëm pyetjeve të Mbrojtjes. Kjo është e reflektuar
7 në transkriptin e asaj dite në faqen 25588, 25590.

8 Trupi Gjykses rrjedhimisht vlerëson se janë përmbushur
9 kushtet apo kriteret sipas rregullës 143(2) [Sipas
10 përkthimit].

11 Trupi Gjykses vlerëson më tej se rregulla 143(2) (c)
12 parasheh se mund të pranohet një deklaratë e mëparshme
13 mospërputhëse për vlerësimin e besueshmërisë së dëshmitarit si
14 dhe për vërtetësinë e përmbajtjes së saj apo për qëllime të
15 tjera që janë në diskrecionin e Trupit Gjykses.

16 Trupi Gjykses vlerëson se mungesa, pra mospërpjekjet për
17 të dhënë dëshmi, në fakt, mund të konsiderohen një deklaratë e
18 mëparshme mospërputhëse. Mund ta shihni një rast konkret në
19 vendimin 01821, paragrafi 49. Kështu që rregulla 143(2) (b) dhe
20 (c) mund të lexohet së bashku në këtë rast.

21 Trupi Gjykses vlerëson se palët pajtohen se deklarata e
22 2001-shit të këtij dëshmitari, në fakt, nuk është në përputhje
23 me dëshmi të tjera që ka dhënë ky dëshmitar, këtë mund ta
24 shihni në transkript në faqet 25575, 25576 ,25583. Trupi
25 Gjykses po ashtu është i bindur se mospërpjka e njëmendtë e

1 këtij dëshmitari për të dhënë dëshmi lidhur me aspektet për të
2 cilat ka dijeni dhe i ka përmendur në deklaratat e mëparshme
3 dhe në shënimet përgatitore bën që intervista e 2019-s,
4 shënimi përgatitor dhe provat materiale shoqëruese të
5 konsiderohen mospërputhëse.

6 Sa i takon pranueshmërisë të deklaratës së mëparshme të
7 Dëshmitarit 04745 dhe shënimit përgatitor bashkë me tri provat
8 materiale shoqëruese në bazë të rregullës 138, Trupi Gjykses
9 vlerëson se dëshmia e tij është relevante sa i takon fakteve,
10 rrethana që janë themelore për akuzat që ngrihen në aktakuzë,
11 veçanërisht sa i takon strukturës, organizimit dhe hierarkisë
12 të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës si dhe krimet për të cilat
13 ngrihen akuza në aktakuzë. Rrjedhimisht Trupi Gjykses vlerëson
14 se deklaratat e mëparshme të dëshmitarit, shënimi përgatitor
15 dhe provat materiale shoqëruese janë relevante për këtë proces
16 gjyqësor sa i takon informacionit që përmbajnë, por edhe për
17 besueshmërinë e këtij dëshmitari.

18 Sa i takon autenticitetit, Trupi Gjykses vëren fillimisht
19 se Mbrojtja e Krasniqit konteston deklaratën e 2001-shit si
20 një deklaratë në vetvete meqë Dëshmitari 04745 mohon ta ketë
21 dhënë këtë deklaratë. Trupi Gjykses rikujton një vendim të
22 mëhershëm që ka marrë në parashtrimin F02580, në paragrafin
23 10, ku ka konstatuar që shënimi hetimor i përgatitur gjatë një
24 hetimi penal që riprodhon informacione të dhëna nga një
25 dëshmitar cilësohet si një deklaratë. Fakti që dëshmitari e ka

1 mohuar që ka bërë një deklaratë të tillë nuk ka lidhje me këtë
2 konstatim. Trupi Gjykues bindet që deklarata e 2001-shit e
3 Dëshmitarit 04745 i përmbush kriteret duke qenë se është
4 prodhuar nga hetuesit gjatë një hetimi penal dhe që deklarata
5 jep informacion që është ofruar prej hetuesve për Dëshmitarin
6 04745. Më tej Trupi Gjykues vëren se deklarata e 2001-shit e
7 Dëshmitarit 04745 përmban shumë indicie të autenticitetit dhe
8 mbështetshmërisë. Është një deklaratë e cila ka datë, përmban
9 gjithashtu dhe emrat dhe nënshkrimet e hetuesve përkatëse si
10 dhe hollësitë personale të Dëshmitari 04745, dhe përfshihet
11 gjithashtu në një shabllon zyrtar.

12 Gjithashtu, Trupi Gjykues vëren se palët janë pajtuar që
13 deklarata e 2001-shit përmban papajtueshmëri të caktuara. Këto
14 përcaktohen në transkript në faqe 25575, 25576 dhe 25583.
15 Pavarësisht kësaj, Trupi Gjykues rikujton që i takon Trupit
16 Gjykues në një fazë të mëvonshme të vlerësojë besueshmërinë e
17 dëshmitarit dhe sa të mbështetshme janë dëshmitë e tij duke i
18 marrë në kontekstin e të gjithë dëshmime të paraqitur përpara
19 Trupit Gjykues dhe të pranuar në gjykim, në pajtim me
20 rregullin 139(2). Dhe si rezultat Trupi Gjykues do vlerësojë
21 mungesën e konsistencës dhe pajtueshmërisë ndërmjet
22 deklaratave të shumta të dhëna në këtë kontekst.

23 Trupi Gjykues vëren se intervista e 2019-s e Dëshmitarit
24 04745 përmban indicie të shumta të autenticitetit dhe
25 mbështetshmërisë, përfshirë këtu transkriptin e intervistës në

1 versionin audio dhe video; data e intervistës dhe
2 identifikimin e personave që kanë qenë të pranishëm aty si të
3 qarta; si dhe dëshminë që është dhënë nën detyrimin për të
4 thënë të vërtetën. Dhe dëshmitari ka dhënë njohuritë e veta
5 dhe këto i ka dhënë nën betim.

6 Po ashtu shënimi përgatitor përshin data të intervistës
7 dhe gjithashtu thotë edhe kush ka qenë persona të pranishëm.
8 Dëshmitari po ashtu është informuar për të drejtat e tij.

9 Trupi Gjykues më tej bindet se provat materiale
10 shoqëruese të cilat përbëhen nga një skicë e vizatuar nga
11 Dëshmitari 04745 dhe dy raportet përmbajnë indicie të shumta
12 lidhur me autenticitetin. Në veçanti, dy raportet kanë data,
13 janë të nënshkruara dhe japin numra reference relevante. Trupi
14 Gjykues është i bindur gjithashtu që provat materiale
15 shoqëruese nga pjesë të pandara dhe të rëndësishme të dëshmisë
16 së Dëshmitarit 04745 të dhëna në skicë si dhe në dy raporte
17 janë komentuar mjaftueshëm gjatë seancës përgatitore nga
18 Dëshmitari 04745.

19 Sa i takon argumentit së Mbrojtjes së Veselit dhe seancës
20 përgatitore dhe që thotë që është seanca përgatitore përmban
21 dëshmi të reja - dhe kjo jepet në transkript në faqen 25546 -
22 Trupi Gjykues vëren se, ndërsa këto dokumente përfshihen në
23 paragrafët 120, 142 të shënimit përgatitor dhe duken sikur nuk
24 janë i treguar Dëshmitarit 04745 gjatë intervistës së ZPS-së
25 në vitin 2019, Trupi Gjykues vëren se thelbi i çështjeve është

1 diskutuar me Dëshmitarin 04745 dhe gjithashtu është ngritur në
2 intervistën e 2019-s së ZPS-së. Përveç kësaj, Mbrojtja ka
3 pasur gjithë mundësitë e mundshme për të bërë pyetje për
4 dëshmitarin dhe për të nxjerrë prej tij materialin për të
5 cilin është i interesuar.

6 Lidhur me vlerën provuese dhe paragjykimin, Trupi Gjykses
7 vlerëson se të gjitha ekipet e Mbrojtjes kanë pasur mundësinë
8 që të marrin në pyetje këtë dëshmitar. Mbrojtja do të ketë
9 mundësi të plotë që të bëjë parashtimet e veta sa i takon
10 peshës që i duhet dhënë dëshmime të mëparshme të Dëshmitarit
11 04745, shënimit përgatitor, provave shoqëruese në dosjen
12 përfundimtare dhe në parashtimet përfundimtare të saj. Trupi
13 Gjykses bindet që vlera provuese e deklaratave të mëparshme
14 dhe e shënimit përgatitor të Dëshmitarit 04745 si dhe provat
15 materiale shoqëruese nuk zhbëhet nga efekti paragjykses i
16 tyre.

17 Këtu përfundon arsyet e Trupit Gjykses për pranimin e
18 këtij dokumenti në pajtim me rregullin 138 dhe rregulla
19 143(2)(b) dhe (c), deklaratat e mëparshme të Dëshmitarit 04745
20 dhe shënimin përgatitor, me redaktimet përkatëse sikurse palët
21 kanë rënë dakord, si dhe provat materiale shoqëruese.

22 A mund të na jepni një datë për sa i takon dorëzimit të
23 dosjes që lidhet me seancën e ditës së sotëm?

24 Z. HALLING: [Përkthim] Besojmë që do kemi mundësi që ta
25 dorëzojmë sot.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po
2 kundërpërgjigjet?

3 Z. ROBERTS: [Përkthim] Do të duhet të marrim përgjigjen
4 një herë, dokumentin, pastaj mund të japim një indicie, mund
5 të japim një datë se kur mund të përgjigjemi.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull. E
7 kuptojmë.

8 Z. ROBERTS: [Përkthim] Thjesht, domethënë, nuk dua të
9 bëjmë paragjykime, nuk duam që të japim një vlerësim të
10 parakohshëm sepse duhet të shikojmë një herë përmbajtjen e
11 kërkesës së ZPS-së dhe pastaj të japim përgjigjen tonë.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] E kuptoj.

13 A ka ndonjë gjë tjetër Prokuroria për të thënë?

14 Z. HALLING: [Përkthim] Jo, nuk kemi asgjë për të thënë.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po ekipet e
16 Mbrojtjes?

17 Z. MISETIC: [Përkthim] Nuk kemi asgjë nga ana jonë.

18 Z. ELLIS: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, nuk e di nëse më
19 lejoni të them diçka.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po.

21 Z. ELLIS: [Përkthim] Kemi gjashtë dokumente që kanë numër
22 provizor provash, nuk janë pranuar përfundimisht si prova dhe
23 për këtë arsye doja që t'jua sillja në vëmendje këtë gjë.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Besoj që kemi
25 një listë të këtyre dokumente dhe do t'i trajtojmë ato kur të

1 vijë momenti.

2 Z. ELLIS: [Përkthim] Faleminderit, thjesht doja t'jua
3 sillja në vëmendje.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit
5 që na e kujtuat.

6 Atëherë do ta mbyllim këtu seancën, dhe seancën e radhës
7 do ta planifikojmë -- besoj që nuk është me datë 15 prill, apo
8 jo, sepse ca vetë nuk do jenë të pranishëm, kështu që do ta
9 bëjmë pas datës 15. Domethënë, do bëjmë planifikimin përkatës
10 dhe do ju njoftojmë. Më pas ne do marrim hapat përkatës duke
11 prezumuar që ju e keni përfunduar lëndën tuaj deri në atë
12 pikë.

13 Faleminderit.

14 --- Seanca mbyllet në orën 09.26

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25